

URDHËR

Nr.28.Dt.25.01.2005

Per Procedurat e import, export dhe tranzitimit te kafsheve, produkteve ushqimore me origjine shtazore dhe ushqimeve per kafshet.

Mbeshtetur ne nenin 102, pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, Mbeshtetur ne ligjin Nr.9308, Dt.04.11.04 “Per Sherbimin dhe Inspektoriatin Veterinar”.

U R D H E R O J:

Duke filluar nga dt.01.01.2005 kompetencat per rregullimin e import,eksport,tranzitim te mallrave me origjine shtazore dhe kafsheve te gjalla ndryshon si me poshte:

1-Te gjithë subjektet qe jane subjekt i ligjit mbi sherbimin dhe inspektoriatin veterinar te mesiperm do u jepet nje autorizim 1 vjecar nga autoriteti kompetent qendror (Drejtoria Veterinare) pasi te jene kontrolluar, regjistruar sipas rregulloreve perkatese te dala nga Drejtoria Veterinare per ushtrimin e aktivitetit te tyre nga autoriteti veterinar i qarkut.

Autorizimi i dhene nga Drejtoria Veterinare do ti sherbeje subjektit per ta paraqitur jashte territorit te tij ne rast se aktiviteti i tij eshte i lidhur edhe me rajone te tjera te Shqiperise apo kur subjekti ka aktivitet me jashte, do ta paraqese ne posten e inspektimit kufitar.

2-I gjithë dokumentacioni qe deri me 31.12.2004 eshte paraqitur prane Drejtorise Veterinare nga subjektet juridike qe jane subjekte te ketij ligji, duke filluar nga dt.01.01.2005 do te paraqiten prane sektorit veterinar te qarkut ku dhe ushtrojne aktivitetin.

3-Drejtoria Veterinare duke bashkepunuar me Organizaten Boterore te Shendetit te Kafsheve dhe duke u mbeshtetur ne kodin Nderkombetar te Shendetit te Kafsheve, Manuali “Per Postat e Inspektimit Kufitar”dt.03.07.2000, pergatit urdherin e Ministrit per bllokim apo lejim te import-eksporteve te kafsheve te gjalla dhe te produkteve me origjine shtazore.

4- Cdo Urdher Ministri i tille i vihet ne dispozicion;

-Postave te inspektimit veterinar kufitar,

-Sektoreve veterinar te qarqeve,

-Subjekteve juridike private nepermjet perfaqesuesit te shoqates se tyre,

-Institucioneve shteterore qe jane te interesuara.

5-Ne lidhje me subjektet juridike qe merren me import medikamentesh veterinare ne vend te pikes 3 te ketij urdheri,vendoset qe ne territorin e RSH futen ato medikamente veterinare qe jane te regjistruara dhe te certifikuara nga komisioni shtetror i medikamenteve veterinare dhe qe vihen ne dispozicion ne institucionet sipas pikes 4 te ketij urdheri.

Ky urdher hyn ne fuqi me dt.01.01.2005.

MINISTRI

Agron DUKA